

Falënderimet i takojnë Allahut ndërsa përshëndetjet qofshin mbi Muhammedin, alejhi's selam!

Allahu thotë: “?????? ?????? ?????? ?????? ?????? ?????????? ?????? ??????”

...Pendohuni të gjithë te All-llahu, o besimtarë, në mënyrë që të gjeni shpëtim”. ( )

“????????? ?????? ?? ?????? ??????”

...kërkoni falje prej Zotit tuaj dhe kthejuni Atij...”. ( )

“?? ?????? ?????? ?????? ?????? ?????? ?????? ?????? ?????? ??????”

O ju që keni besuar, pendohuni tek All-llahu me një pendim të sinqertë...”. ( )

Muhammedi, alejhi's selam ka thënë:

“??? ?????? ?????? ?????? ?????? ?????? ??? ?????? ?????? ??? ?????? ?? ??? ??????”

Allahu më shumë gëzohet me pendimin e robit të Vet se sa kur ndonjëri prej jush gjen kafshën e humbur në ndonjë shkretëtirë”. ( )

Ndoshta, vëllezër të nderuar, e kuptuat se për çka dua tç flas? Dua të flas për një derë që nuk mbyllet: Derën e Pendimit! Dera e pendimit nuk mbyllet, ajo është dhunti e Allahut për këtë ummet të Muhammedit, alejhi's selam, andaj lum për ne që kemi një derë të tillë!

O vëllezër, kush nuk ka nevojë për pendim?! Të gjithë kemi nevojë për të madje për çdo ditë.

Muhammedi, alejhi's selam ka thënë:

“????????? ??? ?????????? ?????????? ?????? ?????? ?? ?????? ?????? ?????? ?????? ??????”

Pasha Allahun, unë kërkoj falje tek Allahu dhe pendohem tek Ai gjatë ditës më shumë se 70 herë”. ( )

O Zot i Madh!, Muhammedi, alejhi's selam kërkon falje 70 herë ndërsa ne shfaqim mendjemadhësi dhe nuk pendohemi!

Pendimi vlen për çdo njeri; muslimanin dhe jomuslimanin, të sinqertin, mëkatarin dhe hipokritin, dijetarin e injorantin, burrin e gruan; me një fjalë, për çdo njeri pa dallim gjinie, race, pozite a moshe. Pendimi, siç thonë dijetarët, është obligim për çdo mëkat të bërë. Nëse mëkati është në raport njeri

Allah, atëherë ai ka tri kushte:

- Largimi i menjëhershëm nga mëkati,
- keqardhja për bërjen e mëkatit, dhe
- vendosmëria për të mos iu kthyer më atij.

Nëse pendimi nuk e ka ndonjërin prej këtyre kushteve, atëherë ai nuk vlen. Ndërsa nëse mëkati është në relacion njeri-njeri, atëherë ai ka edhe një kusht shtesë:

- T'ia ktheje hakun vëllait apo atij që i ka bërë keq.

Nëse është pasuri, ia kthen, nëse është shpifje kërkon falje apo ta kërkoj të drejtën juridike. Ndërsa nëse e ka përgojuar, atëherë ia kërkon hallallin.



O robër të Allahut, t'ia keni frikën Allahut sot ngase, siç keni lindur vetëm, po ashtu do t, vdisni, varroseni dhe ringjalleni vetëm. T'ia keni frikën Allahut sot ngase, pasha Allahun, varri është shumë i frikshëm dhe i errët.

O Zoti jonë, zgjero varret tona dhe na mëshiro me mëshirën Tënde o Mëshirues!

Muslimanë!, mos lejoni që epshet të sundojnë me qenien tuaj por ju sundoni ato, dhe, o rob i Allahut, me zë të lartë dhe duart të ngritura lart qiellit thuaj: O Zoti im, unë jam robi Yt i varfër, kam bërë mëkate të shumta andaj më fal dhe prano pendimin tim! Bëje syrin të loton, zemrën të përulet dhe shpirtin të qanë!

Burimi: [www.twbh.com](http://www.twbh.com)

Përshtati në shqip: [Sedat G. Islami](#)